

VENDIM
Nr. 218, datë 11.3.2015

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE RREGULLAVE PËR SHFRYTËZIMIN, NË SIPËRFAQE DHE NËNTOKË, TË ZONAVE QË JANË NGJITUR ME LEJET EKZISTUESE DHE NDRYSHIMIN E KOORDINATAVE PËR LEJET MINERARE TË PËRCAKTUARA NË HAPËSIRË ME TRI KOORDINATA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 1, dhe 57, pika 2/1, të ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Procedurat, kriteret dhe rregullat për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur me lejet ekzistuese

1. Subjektet e licencuara me leje shfrytëzimi mund të kërkojnë një sipërfaqe shtesë, ngjitur me konturet e lejes ekzistuese, në një nga rastet, kur:

- a) janë në përfundim të rezervave në zonën e lejuar;
- b) shprehin interesin e veçantë në përmirësimin e parametrave teknologjikë dhe treguesve të prodhimit;
- c) në rast se u lind nevoja për kryerjen e punimeve kapitale, që shërbejnë për zhvillimin e minierës në thellësi.

2. Kërkesa e subjektit shqyrtohet në rast se sipërfaqja e kërkuar është e lirë dhe subjekti ka zbatuar, në mënyrë korrekte, dispozitat ligjore për lejen/lejet ekzistuese. Në çdo rast, sipërfaqja e kërkuar nuk mund të jetë më e madhe se sipërfaqja e lejes ekzistuese të subjektit.

3. Ministria shqyrton, paraprakisht, kërkesën dhe njofton subjektin brenda 45 ditëve nga data e marrjes së saj. Në rast të pranimi të kërkesës nga ministria, subjekti duhet të aplikojë pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit, me një projekt të plotë tekniko-ekonomik, ku përfshihet zona e lejes ekzistuese dhe shtesa, brenda 30 ditëve nga marrja e lejes së mjedisit, për shtesën përkatëse, të lëshuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Projekti tekniko-ekonomik shqyrtohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për të cilin këshilli teknik i saj vendos brenda 45 ditëve nga data e aplikimit në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

5. Ministri nënshkruan “Aktin e miratimit të lejes”, brenda 90 ditëve nga data fillestare e aplikimit të subjektit në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

6. Afati i vlefshmërisë së lejes, për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur me lejen ekzistuese, do të jetë periudha e mbetur deri në afatin maksimal të lejes ekzistuese, duke përfshirë edhe zgjatjen e mundshme 10-vjeçare të saj.

7. Në “Aktin e miratimit” përcaktohet niveli i prodhimit, vlera e investimeve dhe garancia financiare e tyre, vlera e rehabilitimit të mjedisit dhe garancia financiare vjetore e mjedisit.

8. Subjekti dorëzon në QKL garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit dhe garancinë financiare të investimeve jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të “Aktit të miratimit” të lejes së ndryshuar nga ministri.

9. Prodhimi, për sipërfaqen shtesë, duhet të llogaritet deri në afatin maksimal të lejes, përfshirë edhe zgjatjen 10-vjeçare të saj. Në zonën shtesë duhet të garantohet kryerja e punimeve kapitale dhe funksionimi normal i tyre gjatë vazhdimit të shfrytëzimit në thellësi të minierës, për kohën e vlefshmërisë së lejes.

10. Subjektet që, aktualisht, janë lejuar të shfrytëzojnë në sipërfaqe dhe nëntokë të zonave që janë ngjitur me lejet e tyre ekzistuese, janë të detyruara të riaplikojnë, sipas këtij vendimi, brenda

60 ditëve nga hyrja në fuqi e tij, duke plotësuar kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2. Subjekteve që nuk kanë aplikuar brenda afatit, ose që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, u revokohen lejet për shfrytëzimin, në sipërfaqe dhe nëntokë, të zonave që janë ngjitur me lejet e tyre ekzistuese.

11. Përcaktimi i procedurave, kritereve dhe rregullave për ndryshimin e koordinatave për lejet minerare, të përcaktuara në hapësirë me tri koordinata

1. Subjektet me leje minerare, kufijtë e të cilave janë dhënë në hapësirë me tri koordinata, në bazë të ligjit nr. 7796, datë 17.2.1994, “Ligji mineral i Shqipërisë”, i ndryshuar, mund të bëjnë kërkesë për ndryshim të koordinatave të zonës së lejuar. Ministria shqyrton, paraprakisht, kërkesën, në rast se subjekti kërkues ka zbatuar, në mënyrë korrekte, dispozitat ligjore për lejet ekzistuese.

2. Kërkesa duhet të jetë teknikisht e mundshme, të mos mbivendoset me lejet e dhëna më parë si dhe të garantojë sigurinë në punë.

3. Kërkesa për ndryshim të koordinatave mund të bëhet për shkaqe, si më poshtë:

- a) për shkaqe gjeologjike;
- b) kur vërtetohet se vazhdimësia e trupit është jashtë zonës së lejuar;
- c) kur, nga pikëpamja teknologjike, është e nevojshme që shfrytëzimi të vazhdojë nga punimet e zhvilluara në zonën për të cilën është dhënë leja ekzistuese;
- ç) kur hapja e punimeve kapitale është e nevojshme për të shmangur zonat e rrezikshme.

4. Ndryshimi i koordinatave është i mundshëm kur zona e ndryshuar është e kufizuar në planin vertikal nga dy plane horizontale, ku dyshemeja është e kufizuar nga plani horizontal, që ka si kuotë, kuotën maksimale të dyshemesë së lejes ekzistuese dhe për tavan, kuotën minimale të tavanit të saj.

5. Realizimi i ndryshimit të koordinatave të bëhet, si më poshtë:

- a) të hiqet kuota e tavanit, kur mbi sipërfaqen totale të zonës së ndryshuar të lejes nuk ka mbivendosje me një leje tjetër dhe zona e zgjeruar përfshin panelin deri në sipërfaqe;
- b) të hiqet kuota e dyshemesë, kur nuk ka leje poshtë saj, për gjithë zonën e lejuar të ndryshuar.

6. Subjekti, i cili ka takuar trupin mineral në horizontet e sipërme dhe, për efekt të këndit të rënies ose tektonikës, trupi mineral zhvillohet jashtë zonës së lejuar të këtij subjekti, ka përparësi në kërkesën për ndryshim koordinatash ndaj një subjekti tjetër, i cili ka lejen minerare në të njëjtën kuotë me këtë subjekt.

7. Ministria shqyrton, paraprakisht, kërkesën dhe njofton subjektin brenda 45 ditëve nga data e marrjes së saj.

8. Në rast të pranimit të kërkesës nga ministria, subjekti duhet të aplikojë pranë Qendrës Kombëtare të Licencimit me një projekt të plotë tekniko-ekonomik, ku të përfshihet edhe ndryshimi i koordinatave, brenda 30 ditëve nga marrja e lejes së mjedisit, për shtesën përkatëse, të lëshuar nga ministri përgjegjës për mjedisin, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Projekti i plotë tekniko-ekonomik, shqyrtohet nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, për të cilin këshilli teknik i saj vendos, brenda 45 ditëve nga data e aplikimit në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

10. Ministri nënshkruan “Aktin e miratimit” të lejes brenda 90 ditëve nga data fillestare e aplikimit të subjektit në Qendrën Kombëtare të Licencimit.

11. Subjekti dorëzon në QKL garancinë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit dhe garancinë financiare të investimeve, jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të “Aktit të miratimit” të lejes së ndryshuar nga ministri.

III. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Në rastin kur një e drejtë minerare është miratuar me marrëveshje koncesionare, nuk zbatohen kriteret, rregullat dhe procedurat, sipas këtij vendimi. Miratimi dhe ndryshimi i koordinatave të lejes përkatëse të shfrytëzimit bëhet sipas kritereve, rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 571, datë 27.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin

e kritereve të përcaktimit të zonave të lejuara minerare për të drejtat minerare të miratuara me marrëveshje koncesionare”.

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama